



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

**THIRRJE PËR MODERATOR PËR EVENTIN MATCH-MAKER  
ALBANIA**

**DATË 26 MARS 2026**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) shpall thirrjen për moderator për eventin Match-Maker Albania, që do të zhvillohet në datë 26.03.2026, Pallati i Kongreseve, në Tiranë. Aplikantët e interesuar duhet të paraqesin një projekt-propozim që konsiston në moderimin e aktivitetit nga ana e tij dhe në realizimin e një programacioni angazhues për pjesëmarrësit përgjatë eventit.

**Përshkrim i eventit dhe i asaj që pritet nga programacioni i moderatorit**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), nën kujdesin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, po organizon edicionin e dytë të forumit MatchMaker Albania, i cili planifikohet të zhvillohet më datë 26 mars 2026, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

MatchMaker Albania është forumi më i madh i investimeve në vend dhe synon nxitjen e investimeve, zhvillimin e partneriteteve strategjike si dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Ky event është konceptuar si një platformë konkrete që krijon hapësira reale për dialog institucional, shkëmbim përvojash dhe identifikim të mundësive të reja bashkëpunimi dhe investimi në Shqipëri.

Edicioni i dytë i eventit do të fokusohet në katër sektorë strategjikë, të organizuar në zona të dedikuara ndërveprimi: Future Estate, Smart Agriculture, Digital Horizons, Power Next (Energy).

Duke qenë se në event do jenë pjesëmarrës të rëndësishëm nga bota e biznesit nga vende të ndryshme dhe për faktin se eventi është i mbushur me aktivitete biznesi (në pesë agenda paralele), lind nevoja e një moderator dhe njëkohësisht krahas moderimit, duhet që moderatorin të realizojë dhe një programacion angazhues për të gjithë pjesëmarrësit (duke patur dhe persona të tjerë në staf, sipas programacionit angazhues që propozon). Programacioni duhet të jetë angazhues, me elemente novatore dhe i veçantë në llojin e tij.

Moderatorimi dhe programacioni do mbahen në gjuhën angleze. Eventin ku kërkohet angazhimi i moderatorit do të zgjasë nga ora 09:00 deri në orën 17:00, në datën 26.03.2026.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**Kriteret që duhet të plotësojë kandidati:**

- të jetë shtetas shqiptarë;
- të kenë mbi 5 vite eksperiencë pune në fushën e moderimit;
- të kenë fituar një profil të rëndësishëm kombëtar në fushën e kërkuar;
- të ketë aftësinë të ideojë dhe realizojë një programacion angazhues për pjesëmarrës të rëndësishëm nga bota e biznesit;
- të jetë njohës dhe folës i shkëlqyer i gjuhës angleze;

**Dosja e aplikimi duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:**

- Jetëshkrimi/Curriculum Vitae;
- Dokumentacioni që vërteton eksperiencën të mëparshme në punë të ngjashme, si kontrata, etj;
- Fotokopje ID/Pasaportë;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Projekt-propozim të detajuar të programacionit
- Buxhet i detajuar për shërbimin.

***Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më 23.03.2026, ora 16:30.***

**Procedura e Përzgjedhjes**

Projekt-propozimet e paraqitura do të shqyrtohen nga një komision i përbërë nga 3 (tre) anëtarë. Fituesi do të shpallet më datë 24.03.2026.

*Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh:*

- karriera e moderatorit;
- aftësia e tij për të moderuar dhe realizuar programacionin në event;



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

- vlerat artistike të propozimit, të programacionit, ku një theks i veçantë do t'i vihet forcës konceptuale dhe evokative të programacionit;
- realizueshmëria financiare në kontekstin e burimeve në dispozicion.

Aplikimi dhe dorëzimi i dosjes së aplikimit me të gjitha dokumentat e cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **[info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al)**.